

KONTRATE PER SHITJE KUOTE

Sot, me date 1 shtator 2022, ne Tirane, palet e meposhtme rane dakord te nenshkruajne kete kontrate per shitjen e kuotes ("**Kontrata**"):

1. SHITESI:

Znj. Eneida Bica, shtetase shqiptare, lindur me 12.07.1989, ne Tirane, me leternjoftim me nr. personal I95712074F ("**Shitesi**"),

dhe

2. BLERESI:

- **Tashko Pustina Sh.p.k.**, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit, me NUIS L11806021V, perfaqesuar nga Znj. Flonja Tashko-Boriçi, ne cilesine e Administratores ("**Tashko Pustina**"),

dhe

- **American Capital Sh.p.k.**, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit, me NUIS K91616024E, perfaqesuar nga Z. Maksim Caslli, ne cilesine e Administratorit ("**American Capital**"),

(referuar bashkerisht si "**Bleresi**").

Shitesi dhe Bleresi se bashku referuar si "**Palet**" dhe vecmas secili si "**Pala**".

DUKE QENE SE:

- I. **FACT Sh.p.k.**, eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit, me NUIS L82008005L, me adrese ne Bulevardi Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake, Qendra Tregtare, Kati 2, Nr. 24, 1019 ("**Shoqeria**").
- II. Shitesi zoteron 100% te kapitalit te Shoqerise, e perbere nga nje pjese (kuote), me vlere nominale 10,000 (dhjete mije) leke ("**Kuota ne Shitje**" ose "**Kuota**").
- III. Shitesi deshiron t'i shese Bleresit Kuoten per nje cmim blerje te barabarte me vleren nominale te Kuotes ("**Cmimi i Blerjes**"), si vijon:
 1. **Tashko Pustina** blen nje pjese qe perfaqeson 50% (pesedhjete perqind) te kapitalit te Shoqerise, kundrejt vleres nominale prej 5,000 (pese mije) leke;
 2. **American Capital** blen nje pjese qe perfaqeson 50% (pesedhjete perqind) te kapitalit te Shoqerise, kundrejt vleres nominale prej 5,000 (pese mije) leke.
- IV. Palet vendosen te lidhin kete Kontrate per shitjen e Kuotes, me qellim transferimin dhe regjistrimin e transferimit te pronesise mbi Kuoten ne Shitje prane QKB-se.
- V. Ne perputhje me Statutin e Shoqerise dhe sipas dispozitave te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar ("**Ligji Tregtar**"), Kuota ne Shitje mund te transferohet pa pengese nga pronesia e Shitesit ne pronesine e Bleresit.



1

PER KETO ARSYE, Palet bien dakort si me poshte:

1. Shitesi i transferon ketu Bleresit Kuoten kundrejt Cmimit te Blerjes, si vijon:
 - 1.1 **Tashko Pustina** blen nje pjese qe perfaqeson 50% (pesedhjete perqind) te kapitalit te Shoqerise, kundrejt vleres nominale prej 5,000 (pese mije) leke ("**Cmimi Tashko Pustina**");
 - 1.2 **American Capital** blen nje pjese qe perfaqeson 50% (pesedhjete perqind) te kapitalit te Shoqerise, kundrejt vleres nominale prej 5,000 (pese mije) leke ("**Cmimi American Capital**").
2. Titulli i pronesise mbi Kuoten ne Shitje kalon nga Shitesi tek Bleresi sipas pikes 1 ketu me siper ne daten e nenshkrimet te kesaj Kontrate.
3. Tashko Pustina do t'i paguaje Shitesit Cmimin Tashko Pustina menjehere me nenshkrimin e kesaj Kontrate ne nje llogari bankare te Shitesit sipas udhezimeve te ketij te fundit.
4. American Capital do t'i paguaje Shitesit Cmimin American Capital menjehere me nenshkrimin e kesaj Kontrate ne nje llogari bankare te Shitesit sipas udhezimeve te ketij te fundit.
5. Deklarime dhe garanci te Shitesit:
 - 5.1 Shitesi deklarlon dhe garanton ndaj Bleresve dhe ne favor te secilit prej tyre se secila nga garancite dhe deklarimet ne vijim jane te verteta dhe te sakta ne daten e nenshkrimet te Kontrates.
 - 5.2 *Personaliteti juridik i Shoqerise:* Shoqeria eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar, regjistruar dhe qe vepron ne perputhje me ligjin e zbatueshem ne menyre te rregullt dhe e regjistruar ne te gjitha organet kompetente ne Shqiperi.
 - 5.3 *Statusi Aktiv:* Shoqeria nuk ndodhet ne gjendjen e paafesise paguese dhe ka aftesi te mbuloje detyrimet e saj qe behen te kerkueshme per 12 muajt e ardhshem, nuk eshte marre asnje vendim dhe s'eshte ndermarre asnje veprim nga Shoqeria, Shitesit apo te trete per likuidimin vullnetar apo te detyruar te Shoqerise ne perputhje me ligjin e zbatueshem dhe se gjithashtu nuk eshte marre asnje vendim dhe s'eshte ndermarre asnje veprim nga Shoqeria, Shitesit apo te trete per riorganizimin e biznesit te Shoqerise ne dobi te kreditoreve, per ristrukturimin, shnderrimin, bashkimin apo ndarjen e Shoqerise apo transferimin e biznesit te saj apo pjeseve te tij tek te trete. Nuk eshte caktuar asnje likuidator apo administrator i posacem falimentimi nga Shitesi, Shoqeria apo te trete dhe s'eshte ndermarre ndonje vendim per caktimin e tij.
 - 5.4 *Pronesia e Kuotes:* Kuota ne Shitje eshte e lire e shkarkuar nga cdo barre e cfaredolloj forme qofte, perfshire por pa u kufizuar ne cfaredolloj te drejtash ne favor te te treteve dhe Shitesi e ka fituar ne menyre te ligjshme pronesine mbi Kuoten dhe ka te drejte dhe zotesi te plote per te shitur dhe transferuar pronesine mbi te ne perputhje me kete Kontrate dhe legjislacionin e zbatueshem.
 - 5.5 *Filialet:* Shoqeria nuk ka asnje filial apo dege ne Shqiperi apo cdo vend tjetër dhe nuk ka asnje pjesemarrje e cila i jep kontroll ose jo mbi persona ne Shqiperi apo jashte saj.
 - 5.6 *Pasqyrat Financiare:* Pasqyrat Financiare te Shoqerise per vitin 2021 dhe ne vazhdim paraqesin nje pasqyre te sakte, te vertete dhe te plote te gjendjes financiare te Shoqerise per periudhen e mbuluar prej tyre dhe jane pergatitur ne perputhje me parimet e kontabilitetit te zbatuara ne menyre te qendrueshme.
 - 5.7 *Regjistrimet Kontabel:* Te gjitha transaksionet financiare te Shoqerise jane regjistruar dhe pasqyruar ne menyre te plote dhe te sakte ne librat dhe regjistrat kontabel te Shoqerise ne perputhje me praktikat zakonore te mira te pranuar per kete qellim dhe



keto regjistrime kane sherbyer si baze per perpilimin e Pasqyrave Financiare. Te gjitha informacionet, regjistrimet, librat kontabel apo sistemet qe kane lidhje me veprimet financiare dhe administrimin e biznesit te Shoqerise jane ne posedim te Shoqerise dhe ruajtja, posedimi apo mirembajtja e tyre nuk varet nga persona te trete.

- 5.8 *Kontratat Kryesore te Shoqerise:* Shoqeria nuk eshte pale dhe nuk ka marre persiper te jete pale e ndonje kontrate apo marreveshjeje kredie apo huaje.
- 5.9 *Veprimtaria e Shoqerise:* Veprimtaria e Shoqerise eshte ne perputhje me ligjin dhe nuk ka detyrime te te papaguara apo depozitime, regjistrime, etj. te pakryera perpara autoriteteve kompetente. Shoqeria dhe Administratori i saj kane vepruar gjithmone dhe veprojne ne perputhje me ligjin e zbatueshem per pastrimin e parave, nuk jane denuar ndonjehere per ndonje veper penale ne Shqiperi apo vend tjeter, nuk jane te pandehur apo hetim dhe ndjekje penale ne Shqiperi apo vend tjeter.
- 5.10 *Proceset Gjyqesore:* Shoqeria nuk eshte perfshire ne asnje proces gjyqesor apo administrativ ne Shqiperi apo jashte saj
6. Shitesi dhe Bleresi bien dakord qe me kerkesen e pare te Pales tjeter dhe/ose Shoqerise, te nenshkruajne dhe te leshojne cdo dokument te nevojshem dhe ne pergjithesi te bejne cdo gje qe eshte e nevojshme qe transferimi i pronesise mbi Kuoten ne Shitje sipas kesaj Kontrate, te regjistrohet prane QKB-se, si edhe prane cdo autoriteti tjeter shqiptar, sipas ligjit, nese eshte nevoja.

Kjo Kontrate bazohet ne Nenin 705 te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise dhe ne Ligjin Tregtar.

PALET

SHITESI

Eneida Bica

Eneida Bica


BLERESI

Tashko Pustina Sh.p.k.

Flonja Tashko-Boriçi

Tashko Pustina - Administrator

American Capital Sh.p.k.

Maksim Caslli

Maksim Caslli
Administrator


AMERICAN CAPITAL
Sh.p.k.
NIPT : K 91616024 E
Rr "Deshmoret e 4 Shteteve" Nderesi 40, Hyrja 8, Ap 55
Tiranë - Albania